



Shoqata e Bashkive dhe e të Zgjedhurve Vendorë

SHOQATA E BASHKIVE DHE E TË ZGJEDHURVE VENDORË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

URGJENTE

Tiranë, 17 gusht 2026

Nr. Prot. 1

Drejtuar:

Shkëlqesisë së Saj Znj. Gunn Marit Helgesen

Presidente e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale

Këshilli i Evropës

Strasbourg

Me kopje:

Z. Konstantinos Koukas

President i Dhomës së Autoriteteve Lokale

Z. Mathieu Mori

Sekretar i Përgjithshëm i Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale

Znj.Sonia Sirtori

Drejtoresh e Komitetit–Demokraci dhe Shtet Ligjor; Asamblea Parlamentare e Këshillit të Evropës.

Elvira Kovacs,

Kryetare e komitetit të monitorimit (PACE))

Ionut Stroe

Bashke-Raportier për Shqipëri (PACE)

Pawel Jablonski

Bashke-Raportier për Shqipëri (PACE)

Lënda: Kërkesë urgjente për monitorim dhe takim lidhur me procesin e rishikimit të Reformës Administrativo-Territoriale në Shqipëri dhe respektimin e standardeve të demokracisë lokale



Shoqata e Bashkive dhe e të Zgjedhurve Vendorë

E nderuar Znj. Presidente,

Shoqata e Bashkive dhe e të Zgjedhurve Vendorë të Republikës së Shqipërisë po ju drejtohet me këtë kërkesë urgjente në një moment të rëndësishëm për të ardhmen e organizimit territorial dhe të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri.

Procesi i rishikimit të Reformës Administrativo-Territoriale të vitit 2014 ka hyrë në një fazë vendimtare. Zhvillimet e fundit kanë krijuar shqetësime serioze lidhur me **plotësinë e procesit të konsultimit, pjesëmarrjen e autoriteteve vendore dhe komuniteteve dhe mënyrën e përmbylljes së punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar.**

Për këtë arsye, kërkojmë një **takim urgjent me drejtuesit përkatës të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës**, me qëllim paraqitjen drejtpërdrejt të situatës dhe të dokumentacionit përkatës.

Qëndrimi institucional i Shoqatës

Dëshirojmë të theksojmë që në fillim një çështje themelore:

Shoqata nuk merr dhe nuk synon të marrë pozicion politik në favor të ndonjë force politike apo të ndonjë prej alternativave të propozuara për riorganizimin territorial të Shqipërisë.

Nuk është detyra e Shoqatës të përcaktojë se cila hartë territoriale duhet të miratohet.

Roli ynë është të përfaqësojmë **shqetësimin institucional të autoriteteve vendore dhe të mbrojmë të drejtën e komuniteteve që ato përfaqësojnë për t'u informuar, konsultuar, dëgjuar dhe përfshirë realisht në vendimmarrjet që prekin territorin, përfaqësimin dhe shërbimet e tyre vendore.**

Prandaj, nuk i kërkojmë Kongresit të mbështesë një hartë të caktuar.

Kërkojmë që procesi nëpërmjet të cilit përcaktohet e ardhmja territoriale e vendit të jetë transparent, gjithëpërfshirës, i bazuar në evidencë dhe në përputhje me standardet evropiane të konsultimit, pjesëmarrjes dhe konsensusit.



I. NJË REFORMË QË PREK DREJTPËRDREJT QYTETARËT DHE PUSHTETIN VENDOR

Rishikimi i Reformës Administrativo-Territoriale nuk është një çështje thjesht teknike apo administrative.

Çdo ndryshim në numrin dhe kufijtë e bashkive ndikon drejtpërdrejt në:

- afërsinë e institucioneve me qytetarët;
- aksesin në shërbimet publike;
- përfaqësimin e komuniteteve;
- zhvillimin e zonave rurale dhe periferike;
- kapacitetin administrativ dhe financiar të bashkive;
- pjesëmarrjen qytetare;
- dhe ushtrimin efektiv të autonomisë vendore.

Për këtë arsye, një reformë e tillë duhet të mbështetet jo vetëm në analiza administrative dhe financiare, por edhe në **një proces real konsultimi me autoritetet vendore dhe komunitetet që do të preken nga ndryshimet.**

II. KALENDARI ZYRTAR DHE PËRFUNDIMI I PARAKOHSHËM I PROCESIT

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale kishte miratuar një **Projektkalendar pune me 16 aktivitete**, të shtrira nga shkurti deri në qershor 2026. Këto përfshinin analizën paraprake, konsultimet dhe dëgjesat publike, angazhimin e institucioneve ndërkombëtare dhe grupeve të interesit, mekanizma të pjesëmarrjes publike, sondazhin publik, vizitat studimore, dokumentin politik, prezantimin e varianteve, paketën ligjore, konsultimet mbi të, shqyrtimin institucional dhe, në përfundim, depozitimin formal të projektpropozimit në Kuvend.



Shoqata e Bashkive dhe e të Zgjedhurve Vendorë

Megjithatë, **puna e Komisionit është deklaruar e përfunduar përpara se ky kalendar të ezauronte fazat e tij të parashikuara.**

Për Shoqatën, shqetësimi nuk lidhet me faktin se cili krah politik e ka marrë këtë vendim.

Shqetësimi lidhet me faktin nëse **një proces i tillë i rëndësishëm është përmbyllur përpara se të realizoheshin të gjithë mekanizmat e konsultimit dhe të analizës që vetë Komisioni kishte planifikuar.**

III. ÇFARË U KËRKUA TË MËSOHEJ NGA KONSULTIMET NË 12 QARQE?

Kjo është një çështje që dëshirojmë ta sqarojmë veçanërisht për Kongresin.

Sipas pikës 4 të kalendarit zyrtar, Komisioni parashikonte:

“Raundi i parë – konsultime dhe dëgjesa publike në 12 qarqe”, për periudhën shkurt–mars 2026.

Këto konsultime **nuk kishin për objekt miratimin paraprak të një harte të re administrativo-territoriale.**

Ato kishin karakter **paraprak dhe diagnostikues**: synonin të dëgjonin qytetarët, autoritetet vendore dhe aktorët e interesuar mbi **ecurinë e Reformës Administrativo-Territoriale të vitit 2014, problematikat e saj dhe nevojën për ndryshime të mëtejshme.**

Kjo dallon thelbësisht nga një konsultim mbi një propozim konkret për shkrirjen ose bashkimin e bashkive.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të mbledhur nga Shoqata, **rreth 90% e pjesëmarrësve në konsultimet e zhvilluara kanë shprehur pakënaqësi ose kundërshtim ndaj konfigurimit territorial të krijuar nga Reforma e vitit 2014.**

Po aq domethënës është fakti se, sipas informacionit të përcjellë Shoqatës, **një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve nuk kanë kërkuar zvogëlimin e mëtejshëm të numrit të bashkive, por, përkundrazi, kanë kërkuar krijimin e bashkive të reja dhe afrimin e qeverisjes me qytetarët.**



Shoqata e Bashkive dhe e të Zgjedhurve Vendorë

Kjo është një gjetje që, konfirmohet nga linku i cdo takimi, procesverbalet dhe dokumentacioni i konsultimeve, dhe duhet të merret seriozisht në analizën e mëtejshme.

Qytetarët u pyetën për përvojën dhe problematikat e hartës ekzistuese; ata nuk u pyetën për të miratuar paraprakisht një hartë të re.

Pikërisht për këtë arsye, kalimi nga këto konsultime paraprake në një vendimarrje konkrete për **shkrirjen e 15 bashkive dhe rikompozimin e hartës territoriale** kërkon një fazë të mëtejshme konsultimi, ku komunitetet të informohen për alternativat konkrete dhe të kenë mundësi të shprehen për to.

IV. NJË BOSHLLËK I RËNDËSISHËM: DËGJESA PËR TIRANËN

Edhe brenda raundit të parë të konsultimeve, ekziston një boshllëk që Shoqata e konsideron veçanërisht të rëndësishëm.

Dëgjesa e parashikuar për Bashkinë e Tiranës nuk është realizuar.

Kjo nuk është një çështje e karakterit politik të Bashkisë së Tiranës.

Rëndësia e saj buron nga fakti se Tirana përfaqëson një territor me peshë të jashtëzakonshme demografike, administrative dhe ekonomike, ndërsa çdo rishikim i hartës territoriale dhe çdo ndryshim në organizimin e zonës metropolitane ka pasoja të drejtpërdrejta për kryeqytetin dhe komunitetet përreth tij.

Për këtë arsye, **mungesa e kësaj dëgjese përbën një boshllëk konkret në procesin e konsultimit**, i cili duhet të merret në konsideratë përpara një vendimarrjeje përfundimtare.

V. AKTIVITETET 5–8 NUK JANË REALIZUAR

Pas raundit të parë të konsultimeve, kalendari zyrtar parashikonte një seri të mëtejshme mekanizmash për zgjerimin dhe thellimin e konsultimit.



Shoqata e Bashkive dhe e të Zgjedhurve Vendorë

Sipas informacionit që disponon Shoqata, **asnjë nga aktivitetet e pikave 5, 6, 7 dhe 8 nuk është realizuar.**

Konkretisht, nuk janë realizuar:

Pika 5 – eventit me institucionet ndërkombëtare dhe grupet e interesit;

Pika 6 – ngritja e faqes zyrtare për punën e Komisionit dhe pritjen e propozimeve nga grupet e interesit dhe komunitetet;

Pika 7 – raundi i dytë i konsultimeve dhe dëgjësave tematike;

Pika 8 – zhvillimi i sondazhit publik.

Këto nuk ishin aktivitete thjesht formale.

Ato ishin mekanizma të parashikuar për **përfshirjen e mëtejshme të aktorëve, mbledhjen e opinionit publik dhe zgjerimin e bazës së informacionit mbi të cilën do të duhej të mbështetej vendimmarrja.**

Për këtë arsye, mosrealizimi i tyre përpara përfundimit të punës së Komisionit krijon një shqetësim të arsyeshëm mbi **plotësinë e procesit konsultues.**

VI. FAZAT E TJERA TË PARASHIKUARA NUK U EZHAURUAN

Përtej pikave 5–8, kalendari parashikonte edhe një seri fazash të mëtejshme:

- vizitat studimore;
- publikimin e “Dokumentit Politik” me opsionet, kriteret dhe vlerësimet;
- prezantimin e 2–3 varianteve;
- hartimin e paketës ligjore;
- raundin e tretë të konsultimeve dhe dëgjësave;
- konsultimin me Këshillin e Ministrave dhe Këshillin Konsultativ;
- shqyrtimin paraprak nga komisionet parlamentare;
- dhe depozitimin formal të projektopozimit në Kuvend.

Këto faza nuk u ezauruan përpara përfundimit të punës së Komisionit.



Shoqata e Bashkive dhe e të Zgjedhurve Vendorë

Për Shoqatën, kjo nuk përbën një gjykim politik mbi produktin përfundimtar të Komisionit.

Është një çështje që lidhet me **raportin ndërmjet kalendarit të miratuar, procesit të zhvilluar dhe nivelit të konsultimit që u arrit përpara vendimmarrjes.**

VII. REAGIMET E KOMUNITETEVE DHE PROTESTAT

Përfundimi i njëanshëm i punës së Komisionit ka ardhur në një kohë kur në pjesë të ndryshme të vendit janë shfaqur **reagime të forta publike, vendime kundërshtuese të Këshillave Bashkiak dhe protesta të komuniteteve.**

Kundërshtimet lidhen veçanërisht me propozimet për **shkrirjen e 15 bashkive dhe rikompozimin e mëtejshëm të hartës administrativo-territoriale**, por edhe me shqetësimin se këto vendime po avancojnë pa u marrë paraprakisht dhe në mënyrë të mjaftueshme mendimi i banorëve të territoreve të prekura.

Shoqata nuk synon të vlerësojë politikisht këto protesta dhe as të mbështesë një alternativë të caktuar.

Por nga këndvështrimi institucional i pushtetit vendor, **reagimi qytetar është një sinjal që kërkon dëgjim dhe konsultim të mëtejshëm.**

Një reformë territoriale e qëndrueshme duhet të jetë jo vetëm administrativisht e argumentuar, por edhe e kuptuar dhe e pranuar nga komunitetet që preken prej saj.

VIII. DY ALTERNATIVA POLITIKE – NJË NEVOJË PËR PROCES TË BALANCUAR

Në përfundim të procesit janë paraqitur qasje të ndryshme politike.

Shumica parlamentare ka paraqitur raportin e saj përfundimtar, ndërsa opozita ka paraqitur një alternativë tjetër të detajuar.



Shoqata e Bashkive dhe e të Zgjedhurve Vendorë

Shoqata nuk merr qëndrim në favor të njërës prej tyre.

Megjithatë, konsiderojmë të rëndësishme që të dy dokumentet të njihen dhe të shqyrtohen në mënyrë transparente dhe profesionale.

Qëllimi nuk është që Kongresi të zgjedhë ndërmjet tyre.

Qëllimi është që Kongresi të mund të vlerësojë nëse procesi nëpërmjet të cilit njëra alternativë do të shndërrohet në vendimmarrje shtetërore ka respektuar standardet e konsultimit, pjesëmarrjes dhe konsensusit.

IX. REZOLUTA 2544 (2024) E PACE-SË

Ky shqetësim duhet parë edhe në dritën e **Rezolutës 2544 (2024) të PACE-së.**

Në pikën 6, PACE, ndërsa njih rezultatet e Reformës Administrativo-Territoriale të vitit 2014, pranon se **përshtatjet e hartës administrativo-territoriale mund të shqyrtohen për të forcuar eficiencën dhe për të adresuar efektet e padëshiruara të reformës.**

Në të njëjtën kohë, ajo thekson se çdo ndryshim në numrin e bashkive apo në kufijtë e tyre duhet të bazohet në **konsensus të gjerë ndërmjet aktorëve të ndryshëm.**

Në pikën 7, PACE lidh disa nga efektet e padëshiruara të reformës me të drejtat e minoriteteve dhe thekson nevojën për konsultim të ngushtë me komunitetet e prekura, përfshirë edhe në kuadër të shqyrtimit të ndryshimeve të mundshme të hartës territoriale.

Në pikën 8, PACE i referohet gjetjeve të raportit të Kongresit të vitit 2021 mbi ndarjen e funksioneve dhe përgjegjësi ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vendore dhe mbi autonominë financiare të bashkive.

Për Shoqatën, këto elemente janë të rëndësishme sepse tregojnë se **rishikimi i hartës është një çështje legjitime, por mënyra e realizimit të tij duhet të respektojë konsensusin, konsultimin dhe interesat e komuniteteve të prekura.**

X. KËRKESA PËR TAKIM URGJENT



Shoqata e Bashkive dhe e të Zgjedhurve Vendorë

Në këto rrethana, Shoqata e Bashkive dhe e të Zgjedhurve Vendorë kërkon një takim urgjent me drejtuesit përkatës të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale.

Në këtë takim dëshirojmë të paraqesim:

1. **Kalendarin zyrtar të punës së Komisionit dhe ecurinë e tij;**
2. **Raportin përfundimtar të shumicës parlamentare;**
3. **Alternativën e paraqitur nga Partia Demokratike;**
4. **Dokumentacionin e konsultimeve dhe dëgjësive në qarqe;**
5. **Dokumentacionin mbi reagimet dhe protestat e komuniteteve;**
6. **Qëndrimet e bashkive dhe këshillave bashkiakë;**
7. **Materialet profesionale dhe dokumentet e tjera relevante.**

Këto dokumente nuk paraqiten për t'i kërkuar Kongresit të zgjedhë ndërmjet alternativave politike.

Ato paraqiten që Kongresi të mund të krijojë një pamje të plotë dhe të balancuar të procesit dhe të vlerësojë nëse autoritetet vendore dhe komunitetet kanë pasur mundësi reale të marrin pjesë në vendimmarrje.

XI. ÇFARË KËRKOJMË NGA KONGRESI

Shoqata nuk kërkon që Kongresi të përcaktojë numrin e bashkive apo hartën territoriale të Shqipërisë.

Kërkesa jonë është institucionale:

të njihet me situatën; të dëgjojë pushtetin vendor; të marrë në konsideratë zërin e komuniteteve; dhe të vlerësojë procesin në dritën e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore dhe standardeve të Këshillit të Evropës.

Nëse Kongresi e çmon të nevojshme, do të mirëprisnim gjithashtu përdorimin e instrumenteve të tij përkatëse të dialogut, monitorimit dhe vlerësimit.



XII. PËR NJË PROCES TË BESUESHËM DHE TË LEGJITIMUAR

Shoqata beson se një reformë territoriale e qëndrueshme duhet të ketë jo vetëm **legjitimitet parlamentar**, por edhe **legjitimitet institucional dhe besim qytetar**.

Kjo arrihet kur:

**autoritetet vendore dëgjohen;
komunitetet konsultohen;
alternativat analizohen;
ekspertët dëgjohen;
dokumentet janë transparente;
dhe vendimmarrja mbështetet në evidencë dhe konsensus.**

Një proces i plotë konsultimi nuk është pengesë për reformën.

Ai është garancia që reforma të jetë më e qëndrueshme, më e besueshme dhe më pranë nevojave reale të qytetarëve.

XIII. PËRFUNDIM

E nderuar Znj. Presidente,

Shoqata e Bashkive dhe e të Zgjedhurve Vendorë dëshiron ta theksojë edhe një herë se **nuk i kërkon Kongresit të mbështesë apo të kundërshtojë një alternativë politike për hartën territoriale të Shqipërisë.**

Ne kërkojmë që **zëri i pushtetit vendor dhe i komuniteteve të mos anashkalohet** në një vendimmarrje që do të ketë pasoja afatgjata për demokracinë lokale, organizimin territorial dhe jetën e qytetarëve.

Pikërisht për këtë arsye, ju kërkojmë një **takim urgjent**, në të cilin të kemi mundësinë t'ju paraqesim dokumentacionin dhe shqetësimet tona në mënyrë të drejtpërdrejtë.



Shoqata e Bashkive dhe e të Zgjedhurve Vendorë

Bashkëngjitur kësaj letre po përcjellim **Aneksin 1 – Kalendarin zyrtar të punës së Komisionit dhe ecurinë e aktiviteteve të parashikuara**, i cili dokumenton fazat e planifikuara dhe aktivitetet që nuk janë ezauruar.

Dokumentacionin tjetër — raportin e shumicës parlamentare, alternativën e opozitës, dokumentet e konsultimeve, qëndrimet e bashkive dhe këshillave bashkiakë, si dhe materialet mbi reagimet e komuniteteve — jemi të gatshëm t'ju paraqesim gjatë takimit.

Besojmë se një takim i tillë do të ishte një kontribut i rëndësishëm për të siguruar që çdo vendim për të ardhmen territoriale të Shqipërisë të merret në përputhje me parimet e demokracisë lokale, konsultimit të komuniteteve dhe autonomisë vendore.

Duke ju falënderuar për vëmendjen dhe duke shpresuar në një përgjigje sa më të shpejtë, ju shprehim konsideratën tonë më të lartë.

Me respekt,

FISNIK QOSJA

KRYETAR

SHOQATA E BASHKIVE DHE E TË ZGJEDHURVE VENDORË

Republika e Shqipërisë

ARLIND HOXHA

DREJTOR EKZEKUTIV

SHOQATA E BASHKIVE DHE E TË ZGJEDHURVE VENDORË

Republika e Shqipërisë





BASHKËLIDHJA NR. 1

KALENDARI ZYRTAR I PUNËS SË KOMISIONIT DHE ECURIA E AKTIVITETEVE

Burimi: “Projektkalendari i Punës së Komisionit Sipas Afateve”. Dokumenti parashikon 16 aktivitete, me afate nga shkurti deri në qershor 2026.

Nr.	Aktiviteti i parashikuar	Afati	Ecuria
1	Takimi i sekretariatit të Komisionit dhe miratimi i projektkalendarit të punës	Shkurt 2026	REALIZUAR
2	Caktimi i Grupit të Ekspertëve	Shkurt 2026	REALIZUAR
3	“Analizë Paraprake” – gjendja e RAT 1, analiza e sfidave vendore, vlerësimi i kornizës ligjore dhe parimet e RAT 2	Shkurt 2026	REALIZUAR
4	Raundi i parë – konsultime dhe dëgjesa publike në 12 qarqe	Shkurt–Mars 2026	I REALIZUAR, por dëgjesa e parashikuar për Bashkinë e Tiranës nuk u zhvillua
5	Event me institucione ndërkombëtare dhe grupe interesi	Mars 2026	PAREALIZUAR
6	Ngritja e një web-faqeje zyrtare për punën e Komisionit dhe pritjen e propozimeve nga grupet e interesit apo komunitetet	Mars 2026	PAREALIZUAR
7	Raundi i dytë – konsultime dhe dëgjesa tematike	Mars 2026	PAREALIZUAR
8	Zhvillimi i një sondazhi publik	Prill–Maj 2026	PAREALIZUAR
9	Organizimi i vizitave studimore	Prill–Maj 2026	PAREALIZUAR
10	Publikimi i “Dokumentit Politik” me opsionet, kriteret dhe vlerësimet	Prill 2026	PAREALIZUAR
11	Prezantimi i 2–3 varianteve	Prill 2026	PAREALIZUAR
12	Paketa ligjore – teksti i ligjit të ndarjes (hartë + anekse) dhe ligji organik i qeverisjes vendore	Maj 2026	PAREALIZUAR



Shoqata e Bashkive dhe e të Zgjedhurve Vendorë

Nr.	Aktiviteti i parashikuar	Afati	Ecuria
13	Raundi i tretë – konsultime dhe dëgjesa për paketën ligjore Propozimi final dërgohet për mendim te	Maj 2026	PAREALIZUAR
14	Këshilli i Ministrave dhe Këshilli Konsultativ Propozimi final dërgohet për shqyrtim	Maj 2026	PAREALIZUAR
15	paraprak të opinioneve nga komisionet parlamentare	Maj 2026	PAREALIZUAR
16	Depozitimi formal i projektpropozimit në Kuvend	Qershor 2026	Nuk është ezauruar sipas procedurave të parashikuara në këtë kalendar

Burimi i aktiviteteve dhe afateve: Kalendar i zyrtar i Komisionit.

Shënim metodologjik

Kjo tabelë nuk synon të japë një vlerësim politik mbi punën e Komisionit. Ajo pasqyron **fazat dhe aktivitetet e parashikuara në dokumentin zyrtar të kalendarit** dhe evidenton, mbi bazën e informacionit të disponueshëm për Shoqatën, ecurinë e tyre.

Çështja që i paraqitet Kongresit është nëse përfundimi i punës së Komisionit përpara ezaurimit të këtyre fazave ka garantuar një proces mjaftueshëm të plotë konsultimi, analize dhe pjesëmarrjeje të autoriteteve vendore dhe komuniteteve të prekura.